

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative,** me gjyqtaren, Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Ganimete Hasani Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditësit, K. R. S., me adresë në rr. "...", nr. ..., P., përfaqësuar nga A. Q. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, nxjerrja e aktit administrativ për shkak të heshtjes administrative, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të palës paditëse, me datën 13 dhjetor 2016, merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. R. S. nga P..
- II. URDHËROHET** e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT)-Komisioni për Ankesa, që në afat prej **30 ditësh**, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të merr aktvendim sipas ankesës së paditësit nr. 3007 të datës 19.06.2013, të parashtruar kundër Vendimit Nr. 4/4-3007 të datës 06.06.2013 dhe aktvendimin t'ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

## **A r s y e t i m i**

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij me padinë e datës 19 shtator 2013 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar nga gjykata që të obligojë të paditurën që të nxjerrë vendim lidhur me ankesën e tij të cilën e ka parashtruar kundër vendimit të shkallës së parë të të paditurës, e me të cilin është vendosur lidhur me kërkesën e tij për njohjen e gradës profesionale të fituar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Pretendon se vendimi i lartcekur bie ndesh me të drejtat e garantuara të paditësit që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës siç edhe mund të vërehet, vendimi i kontestuar vetëm thekson se paditësit i njihet titulli grada profesionale "Juris Doctor" mirëpo nuk përcakton ekuivalencën këtij titulli sipas Sistemit Evropian për Kualifikime. Pohon se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht në komunikimin e realizuar në mes të MASHT dhe W. U., vërehet se ky universitet deklarohet se titulli doktor i juridikut do të duhet të klasifikohet me nivelin 8 të Sistemit Evropian të Klasifikimit. Këtë fakt po ashtu e vërteton edhe komunikimi përmes postës elektronike, MASHT-Departamenti i Arsimit dhe SHBA përkatësisht z. R. N. në të cilin komunikim thuhet se Shoqata e Avokatëve në Amerikë ka leshuar një deklaratë se titulli "Juris Doctor" dhe PHD duhet të konsiderohen tituj ekuivalent për qëllime të punësimit arsimor. Potencion faktin se Shoqata e Avokatëve në Amerikë "A. B. A. është i vetmi institucion që bën akreditimin e fakulteteve juridike në universitetet amerikane. Më tutje shton se duke e konsideruar vendimin e lartcekur si të kundërligjshëm brenda afatit ligjor paditësi ka paraqitur ankesë kundër këtij

vendimi, ndërsa Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i MASHT është dashur që në lidhje me ankesën të vendos në afatin prej dy muajve nga dita e parashtrimit. Pasi që MASHT kishte tejkaluar afatin ligjor për dhënien e një përgjigje në lidhje me ankesën, paditësi në përputhje me nenin 29 të LKA ka kërkuar që vendimi të nxirret në afatin shtesë prej 7 ditëve, mirëpo edhe në këtë afat komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASHT ka dështuar që të nxjerrë një vendim meritore dhe për këtë arsye mendon se janë plotësuar kushtet ligjore që vendimi të atakohet në procedurë gjyqësore. Përfaqësuesi i paditësit, gjithashtu i propozoi gjykatës që të angazhojë një ekspert të arsimit me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike. Konsideron se vendimi i atakuar bie ndesh me depozitat ligjore dhe njëherit paditësit i ka shkaktuar dëm shumë të madh financiar dhe moral, andaj kërkon nga gjykata që të vendosë në mënyrë meritore lidhur me këtë çështje dhe të aprovojë padinë si të bazuar.

E paditura në përgjigje në padi të datës 5 shkurt 2015, e ka mohuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe pretendon se MASHT ka vepruar drejtë për arsye se në bazë të dispozitave të cekura në vendimin e atakuar dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar nga ana e paditësit, ka vendosur që t'i njihet grada profesionale e fituar në W. U. SHBA, ashtu siç është precizuar në dokumentin e lëshuar nga ky institucion. Thekson se në bazë të dokumentacionit të ofruar nga paditësi dhe nga informacionet e marra nga institucionet përkatëse nga universiteti ku janë kryer studimet, Këshilli Shtetëror për Njohje arsyeton se programi i studimeve është tre vjeçar dhe se shkalla e doktorit të jurisprudencës në SHBA nuk është konsideruar si një shkallë e doktoratës profesionale, por më tepër si një shkallë e parë profesionale. I propozon gjykatës që të marrë aktgjykim me të cilin e refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor palët ishin ftuar me rregull, mirëpo e paditur ftesës së gjykatës nuk iu kishte përgjigjur dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar. Gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur pa praninë e të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13 dhjetor, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: dosjen e kërkesës nr.5012 të datës 19.10.2012, kërkesën për urgjencë nr.2906 të datës 05.06.2013, vendimin kontestues nr.6/4-3007 të datës 06.06.2013, ankesën e paditësit nr.3007 të datës 19.06.2013, kërkesën e përsëritur të datës 20.08.2013, kopje e Diplomës në emër të paditësit të datës 15.05.2004, njoftimet nga W. U. të datës 15.11.2012 dhe 02.05.2013, komunikimin elektronik të datës 06.02.2013, vendimin nga UP nr.ref. 1/537 të datës 21.05.2009, konkursin nga UP të datës 28.05.2013 si dhe kontratën e punës në emër të paditësit nr.2/656 të datës 28.09.2012.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësit lidhur me institutin e heshtjes administrative dhe konstatoi se konform nenit 29 lidhur me nenin 46.6 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi fillimisht ka parashtruar kërkesë tek e paditura për njohjen e diplomës "Juris Doctor" të lëshuar nga W. U. në SHBA. E paditura duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit, ka nxjerrë Vendimin Nr. 6/4-3007 të datës 06.06.2013 me të cilin

ka vendosur që paditësit t'i njihet grada profesionale "Juris Doctor", studime tre vjeçare, e fituar në W. U.. Në bazë të këtij vendimi pala e pakënaqur është udhëzuar që ankesën ta parashtrojë pranë Komisionit për Ankesa në MASHT. Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, në afat ligjor ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Ankesa në MASHT, mirëpo që kjo e fundit nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me ankesën e paditësit. Paditësi po ashtu ka parashtruar kërkesë të përsëritur tek e paditura, mirëpo që as pas kalimit të afatit ligjor, e paditura nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me ankesën e paditësit. Në mungesë të ndonjë vendimi, pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike administrative, paditësi ka parashtruar padi në gjykatë për shkak të heshtjes së administratës.

Me Udhëzimin Administrativ të MASHT nr. 8/2010 të datës 22.06.2010 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 15 të këtij udhëzimi, përcaktohet se:

*"1. Pala e pakënaqur me Aktvendimin mbi barasvlerën dhe njohjen e diplomës ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.*

*2. Me ankesë pala e pakënaqur i drejtohet Komisionit për Parashtrësia pranë MASHT.*

*3. Komisioni për Parashtrësia do të vendosë në lidhje me ankesën dhe më së voni në afat prej dy muajsh pas pranimit të lëndës.*

*4. Një përfaqësues i Këshillit për Njohje do të ketë të drejtë të jap shpjegime dhe do të jetë anëtar pa të drejtë vote me rastin e shqyrtimit të ankesave në Komisionin për Parashtrësia".*

Po ashtu me nenin 11 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, përcaktohet se:

*"Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë".*

Ndërsa me nenin 29 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është paraparë se:

*"Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa".*

Meqenëse e paditura nuk ka marrë vendim për ankesën e paditësit, gjykata vlerëson se paditësi me të drejtë ka iniciuar kontestin gjyqësor kundër të paditurit, për shkak të heshtjes së administratës, meqenëse marrja e vendimit sipas kërkesës së paraqitur dhe dorëzimi i tij palës në procedurë, është obligim i organit të paditur.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative- juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit, andaj organi i padituri do të ketë parasysht theksimet nga ankesa e paditësit, do të vërtetojë faktet relevante duke marrë në konsideratë obligimin për të klasifikuar edhe nivelin e gradës profesionale (në këtë rast me 8), siç vërtetohet me njoftimet nga W. U., të datës 15 nëntor 2012 dhe 2 maj 2013 dhe pastaj në afatin prej 30 ditësh, të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata në parim ka vendosur për institutin e heshtjes administrative sipas nenit 29 lidhur me nenin 46.6 të LKA-së. Andaj, në seancën e shqyrtimit kryesor nuk e aprovoi propozimin e përfaqësuesit të paditësit për caktimin e ekspertit të arsimit, pasi që konsideroi se nuk është esenciale për dhënien e vendimit meritor si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, 29 dhe 38 si dhe Nenit 46.6 të LKA-së, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.1248/13, me datë 13 dhjetor 2016**

Gj y q t a r j a  
Arjeta Sadiku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate.